



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 24.04.2023

Nr: 63

Ora: 15:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR.13, DATË 20.04.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.04.2023, me pjesëmarrjen e:

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Elvin | LAKO | - | Relator |
| Elvis | ÇEFA | - | Anëtar |
| Ilirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kryetar në bashkinë Lushnje dhe zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Lushnje.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 13 regj., datë 20.04.2023. Në mbledhjen e datës 24.04.2023, ora 15:00, pas relatimit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 12, datë 20.04.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 24.04.2023, ora 15:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Elvin | LAKO | - | Relator |
| Elvis | ÇEFA | - | Anëtar |
| Ilirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |